URDHËR
Nr. 125, datë 12.10.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000/2023, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të VKM-së nr. 111, datë 2.3.2022, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë", të ndryshuar; dhe të VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, zëvendësministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë znj. Enkelejda Muçaj, për miratimin ose refuzimin e kërkesave për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, të cilat nuk janë objekt koncesioni, nënshkrimin e kontratave dhe transferimin e miratimeve, sipas VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", e ndryshuar.
2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga znj. Enkelejda Muçaj, zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
3. Ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, znj. Enkelejda Muçaj, për zbatimin e këtij urdhri.
4. Urdhri nr. 167, datë 8.9.2022, "Për delegim kompetence", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku